

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BM CIGAR SHPK.

KREU I

THEMELIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA

NENI 1
ORTAKET THEMELUES

Sot në datë 11 . 02 . 2022, Ortakët Themelues:

- **Bexhet Muslija**, nënshtetas i Maqedonisë Veriut, lindur me dt. 09.04.1970 ne Shkup, me numër personal identifikimi 0904970450110 sipas Pasaportës No. K1099177, kopje bashkëlidhur këtij dokumenti, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

dhe

- **Visar Rexhepi**, nënshtetas i Maqedonisë Veriut, lindur me dt. 18.06.1976 ne Shkup, me numër personal identifikimi 1806976450106 sipas Pasaportës No. N0053501, kopje bashkëlidhur këtij dokumenti, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

dhe

- **Z. Flamur Bunjaku**, nënshtetas i Zvicres, lindur me dt. 18.04.1973, mbajtës i Pasaportës No. X4647491, kopje bashkëlidhur këtij dokumenti, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Hartojnë këtë Akt Themelimi dhe Statut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “BM Cigar” Sh.p.k., mbështetur në Ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjin 9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjislacionit shqiptar, si më poshtë vijon:

NENI 2
FORMA LIGJORE

2.1 Shoqëria “BM Cigar” Sh.p.k. është person juridik i të drejtës shqiptare e cila themelohet dhe organizohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (në vijim referuar si “Shoqëria”).



- 2.2 Ortakët përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e saj deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakeve përbëjnë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- 2.3 Ortakët gëzojnë kuotën e tyre në Shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kanë dhënë në kapitalin e saj.

NENI 3

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË DHE SELIA E SHOQËRISË

- 2.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe është pa afat të caktuar.
- 2.2 Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga momenti i regjistrimit pranë QKB në Tiranë.
- 2.3 Selia e Shoqërisë është në Tiranë tek: ***Rruga "Themistokli Gërmenji", Ambasador 1, Nr. 11 Shk. 3 kati 2/A1 Njësia Bashkiake nr. 2, Tirane, Shqipëri.***
- 2.4 Ortaket mund të vendosin të transferojnë selinë e Shoqërisë dhe gjithashtu mund të vendosin të hapin degë dhe/ose zyra përfaqësie brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

Shoqëria ka për objekt:

- 1.1 Kryerjen e aktivitetit të importit, eksportit, tregtimin e cigareve puro dhe nënproduktet e tyre si edhe shitjen përmes çdo forme distribucioni të produkteve të duhanit;

KREU II


KAPITALI I REGJISTRUAR

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë do të jetë 10.000 Lek. Kapitali themeltar është i ndarë në 3 (tre) kuota. Kuotat janë ndarë midis ortakëve si vijon:
- **Bexhet Muslija** – 1 (një) kuote e cila përfaqëson **33.4%** të kapitalit themeltar;
 - **Visar Rexhepi** – 1 (një) kuote e cila përfaqëson **33.3%** të kapitalit themeltar; dhe
 - **Flamur Bunjaku** – 1 (një) kuote e cila përfaqëson **33.3%** të kapitalit themeltar
- 5.2 Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të rritet dhe është tërësisht i paguar dhe i nënshkruar nga ortakët.

[2]



- 5.3 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar, si edhe nga pasuri të luajshme ose të paluajshme të dhëna ose që do të jepen të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.
- 5.4 Kuotat e kapitalit derdhen nga ortakët në Bankë, në llogarinë bankare të Shoqërisë dhe derdhjet e kuotave regjistrohen në librin e llogarisë së Shoqërisë.
- 5.5 I gjithë kapitalit themeltar është nënshkruar nga ortakët e Shoqërisë.
- 5.6 Ortakët kanë të drejtë të tërheqin fondet e depozituara si kapital themeltar të Shoqërisë, në rast se Shoqëria nuk regjistrohet në QKB, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e depozitimit të fondeve.


NENI 6

TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

- 6.1 Transferimi i kuotave të ortakëve të Shoqërisë është i vlefshëm si me akt midis të gjallëve ashtu edhe me trashëgimi, vetëm në rast se rezulton se janë respektuar dispozitat e këtij neni.
- 6.2 Në rast transferimi të kuotave midis të gjallëve me akt, ortakëve i takon e drejta e parablerjes. Ortaku transferues më parë duhet të bëjë një ofertë, ortakëve të tjerë me letër rekomande, ku përcakton çmimin e kërkuar për shitjen e kuotave të tij. Në këtë rast secili nga ortakët në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin themeltar ka të drejtën e parablerjes.
- 6.3 Në rast mosmarrëveshesh mbi çmimin e kërkuar, ky i fundit do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i cili miratohet me shumicë të thjeshtë nga asambleja e ortakëve i cili do të përcaktojë çmimin e shitjes duke u bazuar mbi vlerën reale të kuotave.
- 6.4 Në rast mosmarrëveshjeje mbi emërimin e ekspertit kontabël, ky i fundit me shpenzimet e secilës palë, do të zgjidhet nga gjykata ku ka selinë shoqëria dhe me kërkesë të palës së interesuar.
- 6.5 Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kriterëve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
- 6.6 Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, shitësi por edhe blerësi kanë të drejtë të tërhiqen, përkatësisht nga shitja dhe blerja dhe shpenzimet e ekspertit do të jenë në ngarkim të personit që tërhiqet.
- 6.7 Ortaku shitës i kuotave duhet ti transferojë këto të fundit me akt të shkruar ortakut/ëve blerës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e komunikimit dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e vlerësimit.



[3]



- 6.8 E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet brenda një periudhe 30 (tridhjetë) ditore nga data e komunikimit të ofertës ose brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e fiksimit të çmimit nga ana e ekspertit kontabël që është emëruar. Pasi kanë kaluar afatet e mësipërme, shitësi ka të drejtën të transferojë tek të tretët kuotat e tij.
- 6.9 Transferimi i kuotave për shkak trashëgimie bëhet në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit të cilit/ëve i/u takon kjo e drejtë. Rrjedhimisht transferimi përmes trashëgimisë trajtohet ndryshe nga shitja dhe nuk është i kufizuar me dhënien e miratimit e ortakëve të mbledhur në asamblenë e përgjithshme.

NENI 7

FITIMET DHE PASURIA E SHOQËRISË

- 7.1 Fitimet e Shoqërisë i takojnë ortakëve të saj. Sipas ligjit ortakët vendosin për ndarjen ose riqarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.
- 7.2 Shoqëria do të përdorë dhe disponojë pasurisë së saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo-materiale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së vet të akumuluar tek të tjerët. Shoqëria gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit në fuqi.
- 7.3 Shoqëria, vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

KREU III

DREJTIMI I SHOQËRISË

NENI 8

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 8.1 Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e ortakëve të mbledhur në asamble të përgjithshme, të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në këtë Statut. Ndër këto detyra përfshihen:
- a) ndryshimi i statutit të Shoqërisë;
 - b) miratimi i buxhetit vjetor, të veprimtarisë së administrimit, të inventarit, të bilancit të llogarisë vjetore;


[4]

- c) emërimi e shkarkimi i administratorit/ëve qofshin ortake ose jo dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht motivi;
- d) miratimin e kredive dhe të garancive;
- e) miratimi i tarifave për shërbimet që kryen Shoqëria;
- f) përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së Shoqërisë;
- g) zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
- h) mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
- i) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
- j) vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësimeve ose e agjencive të Shoqërisë;
- k) vendimin për riorganizimin dhe mbylljen e Shoqërisë;
- l) vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë Shoqëria, si edhe procedime të tjera ndaj administratorit;
- m) vendimin për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar apo të konsulentëve të tjerë, qoftë persona fizike qoftë juridike;
- n) vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave të procedurës për mbledhjen e asamblesë;
- o) vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të Shoqërisë;
- p) vendimin për shitjet e kuotave të Shoqërisë;
- q) vendimin për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
- r) marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

8.2 Asambleja e përgjithshme e ortakeve thirret:

- a) nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose sipas zgjedhjes së administratorit nëpërmjet postës elektronike. Adresa elektronike e-mail e ortakëve regjistrohet në dokumentet e Shoqërisë.
- b) njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithëve ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

[5]



- 8.3 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur në nenit 8.2 më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit për thirrje.
- 8.4 Vendimet e asamblesë së përgjithshme, merren në formën e vendimeve me shkrim. Pjesëmarrja e ortakut të vetëm apo votimi në asamblenë e përgjithshme, mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike.
- 8.5 Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.
- 8.6 Asambleja e përgjithshme mund të mblihdhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri dhe duhet të jene në përputhje me parashikimet e këtij statuti.
- 8.7 Kuorumi i nevojshëm për të vendosur në asamble e zakonshme dhe/ose jashtëzakonshme është ai i parashikuar në nenet 86, 87 të ligjit 9901 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".


NENI 9

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT

9.1 Asambleja e ortakëve mund të emëroj një ose me shumë administratorë.

9.2 Administratori i Shoqërisë është:

- **Bexhet Muslija**, kombësia shqiptare, nënshtetas i Maqedonisë Veriut, lindur në Shkup, më dt. 09.04.1970, me numër personal identifikimi 0904970450110 sipas Pasaportës No. K1099177, të lëshuar MBP e Maqedonisë Veriut në datë 02.12.2019 e vlefshme deri në 01.12.2029, me vendqëndrim dhe banim në adresën: Shkup-Gazi Babë, RR. Fushtanska Nr. 12A, Shkup, Madqedonine e Veriut, kopje bashkëngjitur;





specimeni i firmës së administratorit

I cili ushtron të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme konform ligjit të Republikës së Shqipërisë.



9.3 Administratori/et emërohet/n me një afat 5 (pese) vjeçar duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR, me të drejtë riemërimi në qoftë se do të emërohet serish administrator/ë nga

[6]



asambleja e ortakeve. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë për shkarkimin e tij. Administratori/et ka/në të drejte të japë dorëheqjen e parakohshme, me aprovim nga ana e asamblesë së përgjithshme, sipas procedurave të parashikuara me ligj.

- 9.1 Asambleja e përgjithshme e ortakeve mund të emërojë edhe më shumë se dy administratorë, të çfarëdo kombësie dhe të jashtëm për Shoqërinë. Në rastin e emërimit të një apo me shumë administratorëve në fuqi, secili nga administratorët mund të ushtrojë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmës sipas kompetencave të përcaktuara që në fillim nga asambleja e përgjithshme e ortakeve e depozituar pranë QKB-se. Secili nga ata do të jetë individualisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të dhëna nga ligji për administratorin dhe do ti komunikojë të tjerëve ose administratorit tjetër veprimet të kryera nga ai.
- 9.2 Administratori dhe/ose administratoret kryen/jnë detyrat e përcaktuara nga ortakët e Shoqërisë në këtë statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të rregulluara me ligj. Ndër këto përfshihen detyrat e listuar me poshtë:
- a) Të përfaqësojë, veproje dhe të nënshkruajë në emër të Shoqërisë.
 - b) Të hartojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin financiar, që do të miratohet në asamblenë e përgjithshme.
 - c) Të marrë vendime lidhur me kreditë që do të merren dhe dhënien e garancive.
 - d) Të përpunojë dhe të paraqesë për miratim në asamblenë e përgjithshme raporte për ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë dhe të bilancit të mbylljes së aktivitetit financiar të vitit paraardhës, sipas asaj që parashikohet në ligj.
 - e) Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme të ortakeve.
 - f) Administratori apo administratoret në rast se do të emërohet më shumë se një administrator është përgjegjës kundrejt Shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit apo të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ecurisë së aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar.
 - g) Të kryejë të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakeve.
 - h) Të kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë me korrektësi dhe saktësi.
 - i) Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojtë dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
 - j) Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



- k) Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme të ortakeve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë.
- l) Marrjen në punë, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna.
- m) Të emërojë financiar e konsulentë për problemet e Shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financiare te tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të Shoqërisë.
- n) Të mirë administrojë me besnikëri Shoqërinë.
- o) Të lidhë marrëveshje me të treta në kufijtë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët.
- p) Të zbatojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë.
- q) Të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara Shoqërisë nga veprimet e tij.
- r) Të shpërblehet për punën që kryen sipas marrëveshjes me ortakun themelues.
- s) Të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson si të rëndësishme për Shoqërinë.
- t) Të kryejë të gjitha veprimet bankare në lidhje me llogarinë e shoqërisë.
- u) Administratori i vetëm apo administratorët ka/në të drejtë dhe detyrë të thërrasë asambleenë e përgjithshme, sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 8.2 të këtij statuti dhe të ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht në statut.

KREU IV
DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMIT NË KAPITAL

NENI 10
TË DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQËRISË

10.1 Shoqëria ka të drejtë:

- a) të kryejë veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
- b) të sigurojë pasurinë e vet;
- c) të marrë kredi në Lekë dhe në valute nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;
- d) të përfitojë nga lehtësitë që i njeht legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera;
- e) të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
- f) të punësojë punëtorë, vendas ose të huaj;

[8]



g) të eksportoje lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

10.2 Shoqëria ka për detyrë:

- a) të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
- b) të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
- c) të sigurojë punonjësit e saj;
- d) të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
- e) të pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkohen nga ligji, për të zbatuar objektin e veprimtarisë së saj;
- f) të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

NENI 11

MARRËDHËNIET EKONOMIKE – FINANCIARE TË SHOQËRISË

- 11.1 E gjithë veprimtaria e Shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.
- 11.2 Në selinë e Shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në baze të cilit, brenda datës 31 Mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë.
- 11.3 Viti financiar fillon çdo vit më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.
- 11.4 Shoqëria mban llogarinë e saj në Bankë. Llogaritë mbahen në LEKË dhe/ose EURO dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatëse.
- 11.5 Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, Shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, le mënjane 5% të fitimit, me të cilin krijohet fondi “Rezervë e domosdoshme”, derisa ky fond të arrijë masën 10% të kapitalit themeltar.


KREU V

SHNDËRRIMI PRISHJA DHE LIKUJDIMI

NENI 12

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa të zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe mund të ketë një markë të vetën. Në rast të krijimit të një faqe interneti, mund të deklarohet në mënyrë vullnetare në QKB.

[9] 

NENI 13
SHNDËRRIMI

Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri të llojeve të tjera, mund të bëhet me vendim të ortakut themelues apo nga asambleja e ortakeve sipas mënyrave të parashikuara në ligj.

NENI 14
PRISHJA E SHOQËRISË

14.1 Prishja e Shoqërisë, mund të vijë për shkaqet e parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 dhe për arsytet si më poshtë:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- me vendim të gjykatës;
- humbja e kapitalit të shoqërisë;



14.2 Në këto raste, ortakët e Shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose me shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së Shoqërisë deri sa ajo t’u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar në radhe të parë detyrimet që ka Shoqëria ndaj personave të trete.

14.3 Në rast se fondet e disponueshëm, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë, likuidatori mund t’i kërkojë ortakut/eve të Shoqërisë që të derdhë tërësisht kuotat që u takojnë.

NENI 15
LIGJI I APLIKUESHËM DHE GJYKATA KOMPETENTE

Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakut/eve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe Administratorit/eve do të nënshtrohen për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

[10]



AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BM CIGAR SHPK.

Ky akt themelimi dhe statut përpilohet ne 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe, të nënshkruara rregullisht nga ortakët themelues të Shoqërisë.

Nënshkruar sot në Tiranë më datë 11.02.2022

<p>Ortaku 1° Bexhet Muslija <u>Bexhet Muslija</u> B. Muslija</p>	<p>Ortaku 2° Visar Rexhepi <u>Visar Rexhepi</u> V. Rexhepi</p>	<p>Ortaku 3° Flamur Bunjaku <u>Flamur Bunjaku</u> F. Bunjaku</p>
---	---	---